



**PHILIPS**

Orë alarmi me  
Bluetooth me  
karikues telefoni me  
valë

PR702



# Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në  
[www.philips.com/support](http://www.philips.com/support)

# Përmbajtja

<b>1</b>	<b>Të rëndësishme</b>	<b>2</b>
	Siguria	2
<b>2</b>	<b>Orë alarmi me Bluetooth me karikues telefoni me valë</b>	<b>3</b>
	Hyrje	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Përmbledhje e orës së alarmit me Bluetooth	4
<b>3</b>	<b>Fillimi</b>	<b>5</b>
	Lidhja me energjinë	5
	Instalimi i baterisë	5
	Vendosja e orës	5
	Ndezja	6
	Rregullimi i ndriçimit të ekranit	6
<b>4</b>	<b>Vendosja e alarmit</b>	<b>7</b>
	Vendosja e alarmit	7
	Aktivizimi/çaktivizimi i alarmit	7
	Shtyrja e alarmit	7
<b>5</b>	<b>Vendosni shtyrjen e alarmit</b>	<b>8</b>
<b>6</b>	<b>Bluetooth</b>	<b>9</b>
	Luajtja nga pajisja Bluetooth	9
<b>7</b>	<b>Karikimi</b>	<b>10</b>
	Përdorimi i karikimit me valë Qi	10
<b>8</b>	<b>Informacione për produktin</b>	<b>11</b>
<b>9</b>	<b>Zgjidhja e problemeve</b>	<b>12</b>
<b>10</b>	<b>Njoftim</b>	<b>13</b>
	Kujdesi për mjedisin	13



# I Të rëndësishme

## Siguria

### paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e kësaj ore alarmi me Bluetooth.
  - Asnjëherë mos lubrifikoni asnjë pjesë të kësaj ore alarmi me Bluetooth.
  - Asnjëherë mos e vendosni këtë orë alarmi me Bluetooth mbi ndonjë pajisje tjetër elektrike.
  - Mbajeni këtë orë radio larg nga drita direkte e diellit, flakët e ndezura ose nxehtësia.
  - Sigurohuni që ta arrini gjithnjë me lehtësi kordonin e energjisë, spinën ose adaptorin për ta shkëputur orën e alarmit me Bluetooth nga energjia.
- Lexoni këto udhëzime.
  - Përmbajuni të gjitha paralajmërimeve.
  - Ndiqni të gjitha udhëzimet.
  - Mos bllokoni asnjë prej vrimave të ajrimit, dhe instalojeni duke ndjekur udhëzimet e prodhuesit.
  - Mos e instaloni pranë asnjë burimi nxehtësie si për shembull radiatorë, pajisje ngrohjeje, soba, ose pajisje të tjera që prodhojnë nxehtësi (përfshirë edhe amplifikatorët).
  - Mos lejoni që të shkelet ose kafshohet me diçka kordoni i energjisë, sidomos pranë spinave, prizave, dhe në pikën ku dalin nga ora e alarmit me Bluetooth.
  - Shkëputeni këtë orë alarmi me Bluetooth gjatë stuhive me vetëtima ose kur nuk përdoret për kohë të gjatë.
  - Drejtojuni personelit të kualifikuar të shërbimit për të gjitha riparimet. Është e nevojshme të bëhen riparime kur ora e alarmit me Bluetooth dëmtohet në ndonjë mënyrë, si për shembull kur dëmtohet

kordoni ose spina e energjisë, kur derdhen lëngje ose mbi orën e alarmit me Bluetooth bien objekte, kur ora e alarmit me Bluetooth ekspozohet ndaj shiut ose lagështisë, nuk punon normalisht ose është rrëzuar.

- KUJDES lidhur me përdorimin e baterisë - Për të mos lejuar rrjedhjet e baterive të cilat mund të shkaktojnë lëndime, dëmtime të pronës, ose dëmtime në orën e alarmit me Bluetooth.
  - Instalojeni baterinë si duhet, + dhe - siç është shënuar në orën e alarmit me Bluetooth.
  - Hiqeni baterinë kur ora e alarmit me Bluetooth nuk është përdorur për kohë të gjatë.
  - Bateria nuk duhet të ekspozohet ndaj dritës direkte të diellit, zjarrit ose burimeve të ngjashme të nxehtësisë.
- Kjo orë alarmi me Bluetooth nuk do të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
- Mos vendosni asnjë burim rreziku pranë orës së alarmit me Bluetooth (p.sh. objekte të mbushura me lëngje, qirinjtë të ndezur).
- Aty ku spina e energjisë të adaptorit direkt Plug-in përdoret si mjet shkëputjeje, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në një vend që arrihet me lehtësi.

### vërejtje

- Etiketa e të dhënave ndodhet poshtë produktit.

## 2 Orë alarmi me Bluetooth me karikues telefoni me valë

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips!  
Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në [www.philips.com/welcome](http://www.philips.com/welcome).



### Hyrje

Me këtë orë alarmi me Bluetooth ju mund të:

- luani audio nga pajisjet me Bluetooth
- shikoni orën
- vendosni dy alarme
- karikoni pajisjet celulare me karikuesin e telefonit me valë ose me USB



### Çfarë ka në kuti



Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:



- Ora e alarmit me Bluetooth
- Adaptor i energjisë
- Materialet e shtypura

## Përmbledhje e orës së alarmit me Bluetooth



- ① **POWER/ **
  - Ndezja/fikja e Bluetooth
- ② **-VOL +**
  - Vendosja e orës dhe minutave
  - Vendosni formatin 12 orë ose 24 orë
  - Ngritja/ulja e volumit
- ③ ****
  - Luaj/pauzë
- ④ **SNOOZE / BRIGHTNESS**
  - Shtyjeni alarmin
  - Rregulloni ndriçimin e ekranit
- ⑤ **Ekrani**
  - Shfaq gjendjen aktuale
- ⑥ **SET TIME/ zZ**
  - Vendos orën
  - Vendosni shtyrjen e alarmit
- ⑦ **ALARM1 / ALARM2**
  - Vendosja e alarmit
  - Aktivizimi/çaktivizimi i alarmit
- ⑧ **Porta e karikimit USB**
- ⑨ **Xheku i adaptorit të energjisë**
- ⑩ **Zona e karikimit me valë**

## 3 Fillimi


Ndiqui gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.

### Lidhja me energjinë

#### ! Kujdes

- Rrezik i dëmtimit të produktit! Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që është printuar mbrapa ose poshtë orës radio.
- Rrezik goditjeje elektrike! Kur shkëputni adaptorin AC, tërhiqni gjithnjë spinën nga priza. Asnjëherë mos tërhiqni kordonin.
- Rrezik shpërthimi! Mbajeni baterinë larg nga nxehtësia, drita e diellit ose zjarri. Asnjëherë mos e hidhni baterinë në zjarr.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria nuk vendoset si duhet. Ndërrojeni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.

Lidhni adaptorin e energjisë me prizën në mur.




### Instalimi i baterisë

Nuk mund të përdorni energji AC si furnizimi me energji. Bateria AAA mund të ruajë vetëm orën dhe alarmin. Kur shkëputet energjia, ekrani fiket.

#### ! Kujdes

- Bateria përmban substanca kimike, prandaj duhet të hidhet në mënyrën e duhur.

Sipas udhëzimeve, në polaritetin e duhur (+ / -) vendosni bateri 1.5V x 2 AAA (nuk janë dhënë).



Ndërrojeni bateritë kur ndizet treguesi për baterinë e ulët

### Vendosja e orës

- 1 Në gjendjen në pritje, mbani shtypur SET TIME për më shumë se 2 sekonda për të aktivizuar vendosjen e orës. Format i orës 24H në ekran do të pulsojë.
- 2 Shtypni butonin - ose + vazhdimisht për të zgjedhur formatin 24 orë (standard) ose 12 orë.
- 3 Shtypni SET TIME për të konfirmuar dhe shifra e orës në ekran do të pulsojë.



- 4 Shtypni butonin - ose + për të rregulluar orën (mbani shtypur butonat për vendosjen e shpejtë)
- 5 Shtypni SET TIME për të konfirmuar dhe shifra e minutave në ekran do të pulsojë
- 6 Shtypni butonin - ose + për të rregulluar minutat (mbani shtypur butonat për vendosjen e shpejtë)
- 7 Shtypni SET TIME për të konfirmuar dhe ora e vendosur do të shfaqet.

---

## Ndezja

Shtypni butonin POWER për ta ndezur orën e alarmit me Bluetooth

---

### Kaloni në gjendjen në pritje

Shtypni butonin POWER përsëri për të kaluar në gjendjen në pritje.

↳ Ora (nëse është vendosur) shfaqet

---

## Rregullimi i ndriçimit të ekranit

Shtypni vazhdimisht BRIGHTNESS për të zgjedhur nivele të ndryshme ndriçimi.

- I lartë
- Mesatar
- I ulët



# 4 Vendosja e alarmit

## Vendosja e alarmit

Mund të vendosni që të bien dy alarme në orare të ndryshme.

### Shënim

- Sigurohuni që ta keni vendosur orën si duhet.
- Në modalitetin në pritje mund të vendosni vetëm alarmin.

- 1 Në modalitetin në pritje, mbani shtypur ALARM1 ose ALARM2 për më shumë se 2 sekonda për të aktivizuar modalitetin e vendosjes së alarmit, ikona e shifrës së orës (🕒) dhe ikona e alarmit (🔔 ose 📞) në ekran do të pulsojnë.
- 2 Shtypni butonin - ose + për të rregulluar orën. Shtypni ALARM1 ose ALARM2 për të konfirmuar dhe shifra e minutave në ekran do të pulsojë.
- 3 Shtypni butonin - ose + për të rregulluar minutat. Shtypni ALARM1 ose ALARM2 për të konfirmuar.
- 4 Shtypni ALARM1 ose ALARM2 vazhdimisht për të zgjedhur burimin e alarmit:
  - Sinjalizuesi (🔔) ndezur
  - Muzika me Bluetooth (📶) ndezur
  - Anulo alarmin

### Këshillë

- Volumi i alarmit nuk mund të rregullohet, por do të rritet gradualisht për t'ju zgjuar me ëmbëlsi.
- Nëse alarmi është vendosur në muzikën Bluetooth por nuk është gjetur asnjë pajisje Bluetooth, alarmi do të kalojë te sinjalizuesi.

## Aktivizimi/çaktivizimi i alarmit

- Në gjendjen në pritje, shtypni ALARM1 ose ALARM2 për të parë konfigurimet aktuale të alarmit.
- Shtypni ALARM1 ose ALARM2 përsëri për të aktivizuar ose çaktivizuar kohën e shtyrjes së alarmit.
  - ↳ 🕒 ose 📞 shfaqet nëse koha e shtyrjes së alarmit është ndezur dhe zhduket nëse është fikur.
  - Për ta ndaluar alarmin, shtypni butonat përkatëse ALARM1 ose ALARM2.
- Për të ndaluar rënien e alarmit, shtypni ALARM1/ALARM2 përkatës. Alarmi përsëritet vetë në ditët me radhë.



## Shtyrja e alarmit

Kur alarmi fiket, shtypni SNOOZE.

- ↳ Alarmi shtyhet dhe bie përsëri nëntë minuta më vonë.



## 5 Vendosni shtyrjen e alarmit



Ora e alarmit me Bluetooth mund të kalojë automatikisht në gjendje pritjeje pas një periudhe të caktuar paraprakisht.

- Në modalitetin e luajtjes me Bluetooth, shtypni **SLEEP** vazhdimisht për të zgjedhur periudhën e shtyrjes së alarmit (në minuta).

### Për të çaktivizuar shtyrjen e alarmit:

Në modalitetin e vendosjes së shtyrjes së alarmit, shtypni **SLEEP** vazhdimisht derisa të shfaqet **[OFF]**.



## 6 Bluetooth

---


### Luajtja nga pajisja Bluetooth

Shtypni POWER vazhdimisht për të zgjedhur modalitetin Bluetooth.

↳  në ekran pulson

Aktivizoni funksionin Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth.

"PHILIPS PR702" shfaqet në pajisje për t'u lidhur.

↳ Nëse lidhja bëhet me sukses, ora e alarmit me Bluetooth pulson dy herë dhe ikona  ndalon së pulsuar.

Tani mund të filloni luajtjen e muzikës në pajisjen tuaj me Bluetooth.

Shtypni +/- për të rregulluar nivelin e zërit.

---

### Rivendosja e Bluetooth

Mbani shtypur POWER për më shumë se 5 sekonda për të fshirë të gjitha informacionet e lidhjes.

Dhe  në ekran pulson


↳ Ora e alarmit me Bluetooth hyn automatikisht në modalitetin me Bluetooth pas rivendosjes.



## 7 Karikimi

### Përdorimi i karikimit me valë Qi

Pajisja karikon me valë telefonat që pranojnë karikimin me valë duke e vendosur telefonin sipër ikonës së karikimit me valë të ikonës të orës së alarmit me Bluetooth. Ikona e karikimit (⚡) në ekran qëndron ndezur gjatë karikimit.




### Porta e karikimit me USB

Produkti ka gjithashtu një portë karikimi me USB për pajisjet që nuk mbështetin karikimin me valë.

## 8 Informacione për produktin

### Shënim

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara.

Dalja e boksit	2W RMS X 2
Fuqia e karikimit me valë	10W
Dalja e karikimit me USB	5V 1,0A
Shtrembërimi harmonik total	< 2 %
SNR	> 50 dB
Energjia (adaptor i energjisë)	Emri i markës: PHILIPS
	Modeli: BQ30A-0902500-G;
	Hyrja: 100-240V~, 50/60 Hz, Maks. 800 mA ;
	Dalja: 9V  2500 mA;
Bateria	2 bateri AAA për energji rezervë për orën dhe alarmin (nuk jepen)
Konsumi i energjisë në gjendje pritjeje	≤ 1 W
Përmasat e produktit - Njësia kryesore	(GjeXLaXThe) 135 x 65 x 135 mm
Pesha e produktit	0,45 Kg

### Shënim

-  do të thotë tension DC.



## 9 Zgjidhja e problemeve



### Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e kësaj pajisjeje.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni sistemin vetë.

Nëse hasni probleme ndërsa përdorni pajisjen, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonit shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips (www.philips.com/support). Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që pajisja është pranë dhe të keni gati numrin e modelit dhe numrin e serisë.

### Nuk ndizet

- Sigurohuni që spina e energjisë AC të orës me alarmit me Bluetooth është lidhur si duhet.
- Sigurohuni që në prizën AC ka energji.

### Ora e alarmit me Bluetooth nuk përgjigjet

- Shkëputeni dhe lidheni përsëri spinën e energjisë AC, më pas ndizeni përsëri orën e alarmit me Bluetooth.

### Alarmi nuk punon

- Vendoseni si duhet orën/alarmin.



# I0 Njoftim

Çdo ndryshim ose modifikim i bërë në këtë pajisje që nuk është miratuar shprehimisht nga MMD Hong Kong Holding Limited mund ta bëjë të pavlefshme autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.



Këtu, MMD Hong Kong Holding Limited deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support).

## Kujdesi për mjedisin

### Hedhja e produktit të vjetër dhe e baterive



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU. Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake.

Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

### Heqja e baterive njëpërdorimëshe

Për t'i hequr bateritë njëpërdorimëshe, shikoni pjesën për montimin e baterive.

### Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin që të ndahet me lehtësi në tre materiale: karton (kutia), pulpë letre (amortizuesi) dhe polietilen (qeset, fletë mbrojtëse sfungjeri).

Sistemi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi ndiqni rregullat vendëse lidhur me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.



Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips NV dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

